

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.
DICTRICT HEATING GJAKOVA J.S.C.

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: (0390) 26 657;
Tel: (0390) 23 160; 21 780; 21 386

Nr. i Biznesit: 70325312

E-mail:ngrohtorja@ipko.org

Kodi i Matjes

Gjakovë, prill 2009

TABELA E PËRMBAJTJES

1 Parathënie.....	3
2 Përkufizime të Termave	3
3 Kushtet e Përgjithshme	6
3.1 Terminologjia	6
3.2 Rrethanat e paparashikuara	7
3.3 Mosmarrëveshjet	8
4 Hyrje.....	8
5 Objektivat	8
6. Fusha e veprimit.....	9
7. Sistemet matëse të energjisë termike për ngrohje	9
7.1 Pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje	9
7.2 Kërkesat minimale për matje	10
7.3 Matjet e kapacitetit (fuqisë) dhe energjisë si dhe parametrave tjerë karakteristike	10
7.4 Specifikimet teknike të pajisjeve matëse	11
7.5 Saktësia e përgjithshme dhe Klasa e saktësisë së Pajisjeve për matjen e energjisë termike për ngrohje	12
7.6 Ruajtja e të dhënave.....	12
7.7 Monitorimi i pajisjeve	12
8. Të dhënat e matjeve dhe mbledhja e të dhënave	12
8.1 Krijimi i bazës së të dhënave dhe përmbajtja e regjistrimeve / shënimeve të saj.....	12
9. Përgjegjësitë për Sistemet Matëse	14
9.1 Instalimi dhe Mbrojtja e Pajisjeve Matëse	14
9.2 Derrogimi dhe rehabilitimi i planifikuar i sistemeve matëse.....	15
9.3 Regjistrimi i sistemeve matëse që nuk janë në pajtueshmëri.....	15
9.4 Periudha e përmirësimit.....	15
10. Siguria e Pajisjeve të Matjes	16
10.1 Vendndodhja e Pajisjeve Matëse.....	16
10.2 Vulosja e Pajisjeve Matëse	16
10.3 Forma e Vulës	16
10.4 Kontrolli i Pajisjeve Vulosëse	17
11 Testimi i Sistemeve / Pajisjeve Matëse	18
11.1 Përgjithësisht	18
11.2 Aprovimi i Tipeve (Llojeve) të pajisjeve matëse të energjisë termike	18
11.3 Kalibrimi dhe Verifikimi	19
11.4 Kalibrimi periodik dhe riparimi gjeneral	19
12. PAGESA PËR SISTEMET MATËSE	20

1 Parathënie

- 1.1.1.1 Kodi i Matjes ka një rol kyç në caktimin e kërkesave për matje komerciale në mënyrë që të lehtësohet veprimi i tregut të energjisë termike për ngrohje. Ai është njëri nga kodet e një seri kodesh teknike që janë modeluar për të siguruar një “fushë loje të njëjtit nivel” për të gjitha palët e involvuara në ngrohjen qendrore dhe shërbimet ndihmëse, duke vendosur kushtet për përdorim jo-diskriminues dhe transparent të rrjetit të ngrohjes qendrore.
- 1.1.1.2 Kodi i Matjes përcakton rregulla të qarta për instalimin dhe përdorimin e matësve të energjisë termike për t'u siguruar që të dhënat e prodhimit, transportit dhe konsumit / furnizimit të jenë në dispozicion për të përkrahur barazimin përfundimtar efikas të transaksioneve të energjisë termike për ngrohje.
- 1.1.1.3 Në përputhje me Ligjin për Ndrohje Qendrore, Operatori i rrjetit të shpërndarjes është përgjegjës për administrimin e gjitha kodeve teknike për energjinë termike duke përfshirë Kodin e Matjes dhe ato janë objekt i miratimit të Rregullatorit para vënies së tyre në zbatim.
- 1.1.1.4 Ç'do prodhues që dëshiron të paguhet për energjinë termike për ngrohje të transferuar në rrjetin e shpërndarjes, fillimisht duhet të instalojë matësin e energjisë termike për të siguruar të dhëna të sakta të energjisë se prodhuar dhe të transferuar, përkatësisht për të përmbushur kërkesat e barazimit përfundimtarë. Operatori i rrjetit të shpërndarjes është i obliguar që ti siguroj pajisjet për matjen e energjisë termike ç'do konsumatori për të siguruar të dhëna të sakta të shpenzimit të energjisë së shfrytëzuar .
- 1.1.1.5 Ç'do konsumatorë i kualifikuar i cili dëshiron të blejë energji termike nga një furnizues, të cilin e zgjedhë vetë, fillimisht duhet të instalojë matësin e energjisë termike për të matur saktësisht sasinë e energjisë se shpenzuar nga ana e konsumatorit dhe për të përmbushur kërkesat e barazimit përfundimtarë.
- 1.1.1.6 Ky **Kod i Matjes** trajton mënyrën e matjes së sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje qendrore dhe përcakton minimumin e kërkesave për sa u përket pajisjeve për matjen e sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje.

2 Përkufizime të Termave

2.1.1.1 Në këtë **Kod të Matjes**, aplikohen Përkufizimet e mëposhtme:

Termi	Shkurtesa	Përkufizimi
Energjia termike për ngrohje	kWh MWh	Energjia termike që shfrytëzohet për ngrohje qendrore e bartur nga prodhuesi deri te shpenzuesi përmes rrjetit shpërndarës për të mbajtur temperaturat në hapësirat e brendshme sipas kushteve dhe standardeve të projektimit që ju dedikohet hapësirave .
Pika furnizuese		Nënstacioni termik në të cilin fluidi bartës i energjisë termike për ngrohje i dorëzohet shpenzuesit të fundit dhe në të cilin bëhet matja e sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje me pajisjet matëse përkatëse.
Kodi i Matjes		Përmbledhja e rregullave dhe procedurave të cilat përcaktojnë mënyrën e matjes së sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje, mënyrën e leximit të pajisjeve matëse, llogaritjen e sasisë

		së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje, faturimit dhe arkëtimit të sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje, e cila është përgatitur nga ana e Prodhuesit të energjisë termike për ngrohje dhe është miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji .
Pajisjet matëse		Instrumentet e regjistruara në regjistrin për certifikimin e pajisjeve matëse, të cilat përdoren në procesin e prodhimit dhe të furnizimit me energji termike për ngrohje.
Tarifa normative		Sistemi i përkohshëm tarifor që përfshinë shpenzimin e llogaritur për metër katror të sipërfaqes së ngrohur.
Konsumatori		Personi juridik apo fizik që furnizohet me energji termike për ngrohje e që ka në pronësi të tij një sistem sekondarë të shfrytëzimit të energjisë termike për ngrohje duke filluar nga pika furnizuese – nënstationi i tij termik.
Ndërmarrja e Ndrohjes		Subjekti që përmbushë një ose më shumë aktivitete të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike për ngrohje, bazuar në licencën e dhënë.
Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike për ngrohje		Sistemi i gypave që bartin energjinë termike për ngrohje nga prodhuesi deri te shpenzuesit dhe gypat e kthimit nga shpenzuesi deri te prodhuesi.
Ndrohje qendrore		Ndrohja e hapësirave nga ana e Ndërmarrjes së Ndrohjes nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike për ngrohje dhe pikave furnizuese.
Sezoni i ndrohjes		Periudha në mes të fillimit dhe përfundimit të furnizimit të shpenzuesve me energji termike për ngrohje, varësisht nga temperaturat e jashtme, e cila është përcaktuar me vendimin e autoriteteve përkatëse qendrore dhe lokale.
Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE		Është organi i pavarur rregullator i krijuar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë .
Forca Madhore (Gjendja e jashtëzakonshme)		Është në lidhje me secilën Palë , çdo ngjarje apo rrethanë përtej kontrollit të arsyeshëm të kësaj Palë e cila rezulton ose shkakton që kjo Palë të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas këtij Kodi të Matjes duke përfshirë, por jo duke u kufizuar me ndonjë apo më shumë nga aktet e mëposhtme: Aktet ose kufizimet e qeverive apo autoriteteve publike; lufta, shpërbërjet, rebelimet apo trazirat civile; grevat, mbylljet e kufijve ose masat e tjera industriale; bllokimet apo embargot; dështimi në furnizimin me energji; nafta, transporti, pajisjet apo mallrat dhe shërbimet e tjera; dëmtimi i objekteve ose godinave magazinuese nga shpërthimet, zjarri, korrozioni, radiacioni jonizues, kontaminimi radio-aktiv, vërshimet, katastrofat natyrore ose veprime neglizhence të tjerëve ose aksidentet; dhe prishja e pajisjeve ose të Palës tjetër.
Prodhuesi (Gjeneruesi)		Personi fizik apo juridik i cili menaxhon ndërmarrjen që prodhon energji termike për ngrohje.
Prodhimi (Gjenerimi) i energjisë termike për ngrohje		Prodhimi i energjisë së termike nga një ndërmarrje e licencuar për këtë aktivitet.
Ndërmarrja vertikalisht e		Ndërmarrja e ndrohjes e cila kryen prodhimin, shpërndarjen dhe

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVE

integruar e ngrohjes		furnizimin me energji termike për ngrohje.
Furnizimi		Dërgimi, shitja ose rishitja e energjisë termike për ngrohje.
Ligji për Energjinë		Është Ligji numër 2004/8 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i dekretuar nga Rregullorja UNMIK/REG/2004/21.
Ligji për Rregullatorin e Energjisë		Është ligji numër 2004/9 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i dekretuar nga Rregullorja UNMIK/REG/2004/20.
Ligji për Ngrrohje Qendrore		Është ligji numër Nr. 03/L-116 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
Licencë		Një autorizim i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji që i lejon mbajtësit të ndërmarrë një aktivitet në sektorin e energjisë për të cilin kërkohet një Licencë sipas provizioneve të tij siç vendoset në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë .
Njehsori (Matësi)		Një pajisje që matë dhe regjistron prodhimin ose shpenzimin e energjisë termike për ngrohje.
Matësi i rrjedhjes		Pajisje matëse e cila e matë rrjedhjen e fluidit bartës të energjisë termike për ngrohje.
Të dhënat e matjes		Janë leximet e njehsorit për energjinë termike të shpenzuar, të cilat shërbejnë për faturim
Rregullator		Është Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), organi rregullator i pavarur i vendosur nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë .
Rregulli mbi Procedurat e Zgjedhjes së Mosmarrëveshjeve		Një rregull mbi procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i vendosur nga Rregullatori në përputhje me nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në tregun e energjisë.
Rregulli mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji për ngrohje Termike		Një rregull mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji i nxjerrë nga Rregullatori në përputhje me nenin 9.1 (f) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë .
Rregulli mbi Procedurat e Drejtimit për Kodin Teknik/Operacional		Një rregull mbi procedurat e drejtimit për kodet teknike dhe operacionale i nxjerrë nga rregullatori në përputhje me nenin 9.1 9 (f) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë .
Komiteti Drejtues i Kodeve Operacionale	OCCG	Komiteti i themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurat e drejtimit të kodeve teknike / operacionale që mbikëqyr funksionimin e këtyre kodeve
Marrëveshja e kyçjes		Një marrëveshje dypalëshe në mes të Operatorit të rrjetit të shpërndarjes dhe një përdoruesi të sistemit e cila i detajon kushtet për kyçje në rrjet.
Pika e kyçjes		Pika e dakorduar e furnizimit e vendosur mes Operatorit të rrjetit të shpërndarjes dhe një pale tjetër
Operatori i rrjetit të shpërndarjes		Pala e përcaktuar sipas kapitullit VI të Ligjit për ngrohjen qendrore e cila posedon licencën për menaxhimin – operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes duke përfshirë dhe njehsorët (matësit) e energjisë termike dhe pajisjet e nënstationit gjer në kufirin e ndarjes në përgjegjësi të Operatorit të rrjetit të shpërndarjes.

Konsumatori i kualifikuar		Konsumatori i cili me plotësimin e kushteve teknike dhe kushteve tjera të parapara ka fituar të drejtën për furnizim me energji termike nga ana e Ndërmarrjes së ngrohjes ashtu siç përcaktohet në Ligjin për ngrohjen qendrore.
Sistemet matëse		Pajisjet e matjes së sasisë së shpenzuar të energjisë termike të montuara në nënstacionin termik të konsumatorit dhe në pikën(at) e kyçje në mes prodhuesit(ve) dhe rrjetit të shpërndarjes.
Ministria		Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës
Qasja në rrjet		E drejta e kyçjes në rrjetin primar të Ndërmarrjes së ngrohjes të konsumatorit të kualifikuar, pas plotësimit të kërkesave nga ky Kod i matjes.
Palë		Personat fizikë dhe juridikë në njërën anë dhe Ndërmarrja e ngrohjes në anën tjetër të cilët marrin pjesë në procesin e furnizimit dhe shfrytëzimit të energjisë termike për ngrohje.
Furnizuesi		Dërguesi, shitësi ose rishitësi e energjisë termike për ngrohje.
Përdoruesi i sistemit		Personat fizikë dhe juridikë në njërën anë dhe Ndërmarrja e ngrohjes në anën tjetër të cilët marrin pjesë në procesin e furnizimit dhe shfrytëzimit të energjisë termike për ngrohje duke shfrytëzuar sistemin e matjes të paraparë me këtë Kod të matjes.

3 Kushtet e Përgjithshme

3.1 Terminologjia

3.1.1 Përveç kuptimeve të veçanta në Përkufizimet e Termave të mësipërme, brenda këtij dokument disa fjalë dhe shprehje kanë kuptimet e mëposhtme: Referimet në gjininë mashkullore do të përfshijnë edhe gjininë femërore dhe referimet në njëjës do të përfshijnë edhe referimet në shumës dhe e kundërta.

Aty ku ky **Kod i Matjes** specifikon dhënien e informacionit me shkrim ose konfirmimit me shkrim, atëherë çdo mjet tjetër i përshtatshëm i transferimit elektronik që i mundëson marrësit ta ruaj informacionin – i tillë si posta elektronike ose FAKSI do ta përmbushnin këtë detyrim.

Përveç rasteve ku qartësisht thuhet ndryshe, të gjitha referimet në seksione do të jenë referime për seksionet e këtij **Kodi të Matjes**.

Koha ose referimet e tjera ndaj kohës do t'i referohen orës standarde në Kosovë e cila është një orë para **Kohës Universale të Koordinuar (UTC)**.

Ç'do referim në një ligj apo rregullore do të jetë referim në atë ligj apo rregullore të aplikueshme në

Kosovë, ose në rast se ato zëvendësohen në ligjin apo rregulloren e re që nga data në të cilën ato hyjnë në fuqi.

3.2 Rrethanat e paparashikuara

3.2.1 Në këtë Kod të Matjes

3.2.1.1 Nëse krijohen rrethana të tilla që dispozitat e këtij **Kodi të Matjes** nuk mund të jenë të zbatueshme në mënyrë të arsyeshme, **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do të konsultohet menjëherë, aq sa është praktikisht e arsyeshme në ato rrethana, me të gjitha palët e dëmtuara dhe **Komitetin e Drejtimit të Kodeve Operacionale (OCGC)** në përpjekje për të arritur marrëveshje në lidhje me masat që duhet të ndërmerren, nëse ka të tilla. Nëse marrëveshja mes **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** dhe atyre palëve nuk mund të arrihet në kohën në dispozicion, **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duke vepruar si **Operator i Arsyeshëm** do të përcaktojë se cilat masa duhet të merren, nëse ka të tilla. **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do t'i njoftojë palët dhe **Rregullatorin** me vendimet e tij dhe arsyet për to, sa më parë që të jetë e mundshme.

3.2.1.2 Kurdo që **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** merr një vendim, do ta bëjë këtë duke marrë parasysh mendimet e shprehura nga palët tjera dhe në çdo rast, atë që është e arsyeshme në të gjitha rrethanat.

3.2.1.3 Pas ngjarjes, **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do t'ia referojë menjëherë të gjitha rrethanat e tilla të paparashikuara dhe të gjitha vendimet e tilla **Komitetit të Administrimin e Kodeve Operative**.

3.2.2 Ndikimi në mundësinë e Palëve për të qenë në pajtueshmëri me këtë Kod

3.2.2.1 Kur një **palë** e ka të pamundur të jetë në pajtueshmëri me detyrimet e saj sipas këtij **Kodi** për arsye të një **force madhore (gjendjeje të jashtëzakonshme)**, ajo duhet t'i dërgojë një njoftim të gjitha palëve të dëmtuara dhe **Rregullatorit** duke detajuar arsyet për pamundësinë e saj që t'i përbushë detyrimet, pse ajo beson se këto arsye janë një rast i **forcës madhore** dhe për kohën sa do të zgjatë ky rast i **forcës madhore**.

3.2.2.2 Gjatë periudhës së **forcës madhore**, detyrimet e **palës** do të pezullohen.

3.2.2.3 Nëse ndonjë **palë** beson se deklarimi i **forcës madhore** është i paarsyeshëm, ajo mund t'ia drejtojë çështjen **Zyrës së Rregullatorit për Energji** për rishikim dhe vendimi i **Zyrës së Rregullatorit për Energji** do të jetë përfundimtar. Në rast se **Zyra e Rregullatorit për Energji** vendos se arsyet për mos-pajtueshmëri nuk ishin rast i **forcës madhore**, atëherë detyrimet e palës e cila pretendon **forcën madhore** nuk do të konsiderohen si të pezulluara.

3.2.3 Menaxhimi i Kodit të Matjes

3.2.3.1 Ky **Kod i Matjes** përgatitet nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** në përputhje me detyrimet e saj sipas nenit 31.f të **Ligjit për Ngrohje Qendrore** dhe miratohet nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** si dhe parashtron kushtet që duhet të plotësohen nga të gjitha palët në rrethanat që mbulon ky **Kod**.

3.2.3.2 Rishikimet e këtij **Kodi të Matjes** do të ndërmerren nga **Komiteti i Administrimit të Kodeve Operative** i ngritur në përputhje me Rregullin e procedurave të administrimit për kodet teknike/operative i miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji. Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do të marrë përgjegjësinë për inkorporimin e ndryshimeve që janë në pajtueshmëri nga **OCGC** dhe janë miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji, ku** dhe do të jepen versionet e amandamentuara (ndryshuara) të **Kodit** sipas kërkesave.

3.3 Mosmarrëveshjet

3.3.1 Përgjithësisht

3.3.1.1 Dispozitat e këtij **Kodi të Matjes** janë të detyrueshme dhe janë në përgjithësi specifike duke mbuluar shumicën e situatave që ka gjasa të paraqiten në fushat e mbuluara nga **Kodi i Matjes**. Të gjitha palët gjatë zbatimit të **Kodit të Matjes** duhet të veprojnë me mirëbesim gjatë gjithë kohës. Qëllimi duhet të jetë përpjekja, sa më shumë që të jetë e mundur, të sigurohet se nuk do të ndodhin mosmarrëveshje.

3.3.2 Procedura e Mosmarrëveshjeve

3.3.2.1 Mosmarrëveshjet që paraqiten si rezultat i zbatimit të këtij **Kodi të Matjes** do të zgjidhen në përputhje me **Rregullin e procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve** të aprovuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**, si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që paraqiten mes palëve të përfshira në ngrohjen qendrore në territorin të cilin e mbulon NQ Gjakova.

4 Hyrje

4.1.1 Ky **Kod i Matjes** ka për qëllim të formojë bazën për matjen komerciale të energjisë termike në tregun e ngrohjes qendrore.

4.1.2 Të dhënat e sakta të matjes janë thelbësore për funksionin e **Ilogaritjes së shpenzimit** dhe për të siguruar qasjen jo-diskriminuese në **rrjetin e shpërndarjes**. Ky **Kod i Matjes** përshkruan të drejtat dhe detyrimet e palëve për sa i përket matjes së energjisë termike për ngrohje si dhe duke siguruar që të dhënat e matjes mund të sigurohen ashtu që të gjithë pjesëmarrësit në treg të kenë të drejta të barabarta.

5 Objektivat

5.1.1 Ky **Kod i Matjes** përshkruan pajisjet matëse që kërkohen për të gjitha pikat lidhëse mes **rrjeteve** nëse është e aplikueshme, mes **rrjetit** dhe **njësive prodhuese** dhe në **pikat e furnizimit** të konsumatorëve - nënstationet e konsumatorëve si pika ndarëse në mes pjesës primare dhe sekondare të rrjetit, si dhe pikat individuale të furnizimit të konsumatorëve në rrjetin sekondar (nëpër apartamente ose lokale afariste të veçanta të ndërtesave shumëkatëshe) në rastet kur mënyra e konstruktimit rrjeti sekondar e mundëson këtë.

Ky kod përcakton të drejtat dhe detyrimet që ka secila palë, veçanërisht **Operatori i rrjetit të shpërndarjes**, duke përfshirë edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e **Rregullatorit**. Gjithashtu mbulon çështje që kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave.

- 5.1.2 Ky **Kod i Matjes** detajon standardet minimale për matjen dhe regjistrimin e sasisë së shpenzuar të energjisë termike për ngrohje që do të përdoren për përcaktimin (llogaritjen) e shitjeve dhe blerjeve të energjisë termike për ngrohje. Ai cakton dispozitat që kanë të bëjnë me instalimin, testimin, mirëmbajtjen dhe vënien në funksionim të **sistemeve të matjes**. Ai përkufizon kërkesat për saktësi, parametrat që do të maten / lexohen dhe kërkesat për mirëmbajtje dhe testim.

6. Fusha e veprimit

- 6.1.1 Ky **Kod i Matjes** përcakton pajisjet që do të sigurohen dhe procedurat që do të ndiqen për matjen dhe regjistrimin e transferove të energjisë me qëllim të barazimit përfundimtar brenda rrjetit të energjisë termike për ngrohje të NQ Gjakova.

- 6.1.2 Dispozitat e këtij **Kodi të Matjes** do të aplikohen për të gjitha kyçjet në rrjet siç janë:

- Pikat lidhëse (të kyçjes) në mes njësisë (njësive) prodhuese dhe **rrjetit të shpërndarjes**;
- Pikat lidhëse (të kyçjes) në mes **rrjeteve** që i përkasin **operatorëve të rrjeteve shpërndarëse** të ndryshme (nëse është e aplikueshme);
- Pikat lidhëse (të kyçjes) në mes rrjetit primar dhe rrjetit sekondar (pikat e furnizimit të konsumatorëve - nënstacionet); dhe
- Pikat lidhëse (të kyçje) në rrjetin sekondar të konsumatorëve individual – pronarë të apartamenteve ose lokaleve afariste të veçanta në ndërtesat shumëkatëshe.

- 6.1.3 Dispozitat e këtij **Kodi të matjes** do të aplikohen për të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët janë:

- Zotëruesit e një licence për të ndërmarrë ndonjërin nga aktivitetet e licencuara të ngrohjes qendrore,
- Zotëruesit e një licence për të ndërmarrë ndonjërin nga aktivitetet e licencuara të ngrohjes qendrore.
- Konsumatorët e ngrohjes qendrore (të kualifikuar ose të pa-kualifikuar), dhe
- Pronarët apo operatorët e ndonjë burimi tjetër të energjisë termike për ngrohje të cilët janë të lidhur në rrjetin shpërndarës të Ndërmarrjes së licencuar të ngrohjes.

7. Sistemet matëse të energjisë termike për ngrohje

7.1 Pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje

- 7.1.1 Për matjen e shpenzimit të energjisë termike për ngrohje qendrore montohet pajisja matëse e energjisë termike për të matur sasinë e shpenzuar të energjisë termike për ngrohje e cila përbëhet prej dy pjesëve kryesore:

Matësi ultrasonik i rrjedhjes së ujit dhe Njësia llogaritëse termike për ngrohje.

7.1.2 Matësi i rrjedhjes së ujit duhet të jetë i projektuar duke u bazuar në kushtet dhe standardet teknike duke marrë parasysh edhe sasinë se domosdoshme të fluidit që i plotëson nevojat e konsumatorit si dhe të transmetojë impulset deri te llogaritësi i energjisë termike për ngrohje.

7.1.3 Pajisja për matjen e shpenzimit të energjisë termike për ngrohje duhet të ketë këto karakteristika:

- Të ketë saktësi të lartë gjatë punës,
- Matjet mos të ndikohen nga prezenca e grimcave dhe papastërti ne rrjet si dhe substancat kimike apo magnetitet në ujin e rrjetit primar të **Operatorit të rrjetit të shpërndarjes**,
- Të ketë fushëveprim të gjerë dinamik,
- Matje statike pa pjesë lëvizëse,
- Të mund të montohet horizontalisht apo vertikalisht,
- Rënia e presionit të jetë sa më e vogël,
- Të ketë dizajn kompakt,
- Sinjalet ultrasonike të jenë intensive,
- Temperatura e ambientit ku do të montohet pajisja: 0° C deri + 55° C,
- Temperatura e ujit punues : parametra teknik te bazuar ne standardet teknike.

PARAMETRA TJERË TEKNIK:

- Presioni maksimal nominal: 25 bar,
- Saktësia e matjes: më e mirë se EN 1434-1, klasa 2,
- Gypi i drejtë në hyrje: min. 5 x DN,
- Lidhja e pajisjes matëse te energjisë termike në instalim të bëhet me elemente përcjellëse te domosdoshme sipas kushteve dhe standardeve teknike.

7.2 Kërkesat minimale për matje

7.2.1 Pikat ku vendosen pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje janë pikat e kyçjes/furnizimit të konsumatorëve, pika(t) e kyçjes së njësisë(ve) prodhuese dhe të rrjetit të shpërndarjes.

7.2.2 Pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje duhet të jenë të një modeli të cilin duhet ta miratojë Ministria e Tregtisë e Industrisë përmes një certifikate, siç tregohet në nënkapitullin 11.2

7.2.3 Sistemet / Pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet relevante teknike dhe me kërkesat e saktësisë siç tregohet në nënkapitullin 7.5.

7.3 Matjet e kapacitetit (fuqisë) dhe energjisë si dhe parametrave tjerë karakteristikë

7.3.1 Parametrat matës të cilët duhet t'i plotësojë Pajisja e aprovuar matëse e energjisë termike për ngrohje varësisht nga kapaciteti i saj:

1. Rrjedhja e fluidit: – sasia e rrjedhjes se fluidit caktohet duke u bazuar nga sasia e nevojshme e energjisë termike për ngrohje për hapësirat që furnizohen me energji termike.
2. Temperatura e fluidit: - temperaturat e fluidit varësisht prej parametrave teknik.
3. Rënia e presionit: 0.05 – 0.10 bar
4. Diametri: diametri i tubit ku montohet pajisja për matjen e energjisë caktohet duke u bazuar nga sasia e humbjeve termike për hapësirat që furnizohen me energji termike.
5. Tensioni furnizues i rrymës elektrike: 3.6 V (bateria) / 24/230 V
6. Kapaciteti: Sipas ngarkesës se nevojshme termike
7. Presioni punues max. 25 bar
8. Ndryshimi maksimal i temperaturës 177° C
9. Ndryshimi minimal i temperaturës 3° C
10. Ekranit : Jepet kodi i pajisjes se propozuar nga projektuesi i certifikuar
11. Indikacionet e ekranit:
 - Njësitë MWh / kWh
 - Vlerat e përgjithshme: 9 999 999 – 999 999,9
 - Vlerat që tregohen: kapaciteti – energjia – rrjedhja – temperatura
12. Temperatura e ambientit ku do të montohet pajisja: 0° C deri + 55° C,
13. Saktësia e matjes: më e mirë se EN 1434-1, klasa 2,
14. Gypi i drejtë në hyrje: min. 5 x DN,
15. Lidhja e pajisjes matëse të energjisë termike në instalim të bëhet me elemente përcjellëse të domosdoshme sipas kushteve dhe standardeve teknike

7.4 Specifikimet teknike të pajisjeve matëse

- 7.4.1 Pajisjet e aprovuara matëse të energjisë termike për ngrohje duhet të jenë në harmoni me standardin EN 1434 dhe OIML R75 class 4
- 7.4.2 Shikimi i Pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje bëhet në harmoni me Rregulloren për kushtet metrologjike për Pajisjet matëse të energjisë termike.
- 7.4.3 Të gjithë matësit duhet të etiketohen me shenjë identifikuese unike dhe ky informacion së bashku me detajet dhe specifikimet teknike duhet të regjistrohen nga Operatori i shpërndarjes.

7.5 Saktësia e përgjithshme dhe Klasa e saktësisë së Pajisjeve për matjen e energjisë termike për ngrohje

7.5.1 Klasa e saktësisë së sistemeve / pajisjeve matëse sipas standardeve EN 1434 dhe OIML R75 duhet të jetë 4 (class 4).

7.5.2 Kufijtë e lejuar të gabimit për sistemet / pajisjet matëse jepen në vazhdim:

1. Saktësia e matjes së temperaturës $\pm 2^{\circ} \text{C}$
2. Saktësia e matjes së energjisë: $\pm 0.1 \%$
3. Saktësia e matjes së rrjedhjes: $\pm 2\%$

7.6 Ruajta e të dhënave

7.6.1 Të gjitha të dhënat e testimit dhe leximit të sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike duhet të ruhen në bazën e të dhënave e cila duhet të krijohet sipas nën-kapitullit 8.1.

7.7 Monitorimi i pajisjeve

7.7.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që gjatë tërë kohës së furnizimit me energji termike për ngrohje të bëjë monitorimin dhe përcjelljen e gjendjes së pajisjeve matëse të energjisë termike për ngrohje.

8. Të dhënat e matjeve dhe mbledhja e të dhënave

8.1 Krijimi i bazës së të dhënave dhe përmbajtja e regjistrimeve / shënimeve të saj

8.1.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarës** është i obliguar të krijojë bazën e të dhënave me të gjitha regjistrimet / shënimet e nevojshme.

8.1.2 Regjistrimet / shënimet të cilat duhet t'i përmbajë baza e të dhënave nga seksioni 8.1.1 janë:

1. Data e matjes së fundit
2. Temperatura e jashtme
3. Temperaturat e ujit të rrjetit primar
4. Temperaturat e ujit në rrjetin sekondar
5. Presioni në rrjetin primar
6. Presioni në rrjetin sekondar

7. Sasia e energjisë termike e shpenzuar për ngrohje e cila tregohet në ekranin e pajisjes matëse
8. Sasia e rrjedhjes e cila tregohet në ekranin e pajisjes
9. Emri i personit të autorizuar i cili i ka mbledhur këto shënime
10. Koha e mbledhjes së këtyre shënimeve.




Fig. 1. Skema funksionale e nënstacionit termik – Pjesa primare
Skema e lidhjes së matësit të energjisë dhe valvulës së rrjedhjes




Fig. 2. Skema e matësit të energjisë dhe valvulës së rrjedhjes

9. Përgjegjësitë për Sistemet Matëse

9.1 Instalimi dhe Mbrojtja e Pajisjeve Matëse

- 9.1.1 Konform dispozitave të nenit 30.2, 32.2 dhe 32.3 të **Ligjit për Ngrohje Qendrore**, pajisjet matëse të energjisë termike, valvulat e matjes së sasisë së rrjedhjes së fluidit dhe elementet tjera përcjellëse të domosdoshme – pjesa primare, duhet të sigurohen nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes**, në rrjetin e të cilit bëhet kyçja.
- 9.1.2 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do të përcaktojë vendin ku duhet të instalohet **pajisja matëse e energjisë termike** duke marrë parasysh kërkesat e këtij **Kodi të Matjes** dhe të gjithë rregulloreve relevante.
- 9.1.3 Pas vënies në punë të **sistemit të matjes së energjisë termike dhe valvulave për matjen e rrjedhjes së fluidit**, **përdoruesi i sistemit** do t'i raportojë te **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** në lidhje me çfarëdo problemi të dyshuar rreth pajisjeve të instaluar.
- 9.1.4 **Përdoruesi i sistemit** do të sigurojë që vendi i zgjedhur të jetë një vend i përshtatshëm për **pajisjen matëse të energjisë termike dhe valvulës së rrjedhjes së fluidit** duke pasur në veçanti parasysh kërkesat për qasje të lirë dhe sigurinë e pajisjes së parashtruar në seksionin 10.1.3.
- 9.1.5 Aty ku **përdoruesi i sistemit** beson se vendi i zgjedhur nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është një pozicion i pa përshtatshëm për **pajisjen matëse të energjisë termike dhe valvulës së rrjedhjes së fluidit** që do të instalohet, **përdoruesi i sistemit** mund t'ia referojë çështjen procedurës së mosmarrëveshjes.
- 9.1.6 Montimi i **pajisjeve matëse të energjisë termike dhe valvuleve për matjen e rrjedhjes së fluidit** duhet të bëhet duke pasur parasysh skemat e treguara në Fig. 1 dhe në Fig. 2.

9.2 Derrogimi dhe rehabilitimi i planifikuar i sistemeve matëse

- 9.2.1 Derrogimi / pezullimi i përkohshëm i dispozitave të këtij Kodi lejohet për sistemet / pajisjet matëse që janë në funksion në datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk i plotësojnë kërkesat e këtij Kodi, me ç'rast lejohet përdorimi i tyre i vazhdueshëm në përputhje me dispozitat e mëposhtme përderisa sistemi / pajisja matëse të mos përmirësohet në mënyrë të planifikuar.
- 9.2.1 Derrogimi / pezullimi i përkohshëm nga paragrafi 9.2.1 i dispozitave të këtij Kodi bëhet me qëllim që:
- 9.2.2.1 Mos të dëmtohet përdoruesi i sistemit nga pa-aftësia e **Operatorit të rrjetit të shpërndarjes** për të përmirësuar pajisjet matëse të energjisë termike;
- 9.2.2.2 Përdoruesit të sistemit t'i jepet mundësia të ndërrojë pajisjet matëse në harmoni me dispozitat relevante të Ligjit të ngrohjes dhe Rregullës për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- 9.2.2.3 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** të ketë të drejtën për rikthim të arsyeshëm të investimit të bërë për instalimin e pajisjeve matëse përmes tarifës së kyqjes në rrjet;
- 9.2.3 Derrogimi / pezullimi i përkohshëm i dispozitave të këtij Kodi nuk lejohet për sistemet / pajisjet matëse që vihen në punë pas datës së miratimit të këtij Kodi.

9.3 Regjistrimi i sistemeve matëse që nuk janë në pajtueshmëri

- 9.3.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që të mbajë regjistrin e të gjitha pajisjeve / sistemeve matëse që nuk janë në pajtueshmëri me këtë kod dhe rregulloret tjera relevante, si dhe me kërkesat tarifore të përdoruesit të sistemit. Regjistri duhet të përmbajë detaje për të gjitha mangësitë e sistemit matës.
- 9.3.2 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që të krijojë një program të përmirësimit të sistemeve matëse të energjisë termike, i cili duhet të sigurojë që të plotësohen standardet e kërkuara brenda një viti nga momenti kur detektohet mangësia (parregullsia)
- 9.3.3 **Konsumatorët e kualifikuar** janë të obliguar, nëse kjo kërkohet në certifikatën e kualifikimit të lëshuar nga Rregullatori, që të instalojnë sistem(e) matës(e) në pajtueshmëri me kërkesat e këtij Kodi brenda afateve të përcaktuara në certifikatën e kualifikimit.

9.4 Periudha e përmirësimit

- 9.4.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që të bëjë zëvendësimin e sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike që nuk plotësojnë kërkesat e këtij Kodi dhe rregulloreve tjera ekzistuese relevante, brenda periudhës përmirësuese 5 vjeçare. **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duhet të pajtohet me **Rregullatorin** rreth një programi korigjues në faza kohore, ashtu që për ç'do vit të periudhës përmirësuese të zëvendësojë numër afërsisht të njëjtë të sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike.
- 9.4.2 Kur pajisjet matëse të energjisë termike nuk ekzistojnë, atëherë, brenda periudhës njëvjeçare nga data e miratimit të këtij Kodi, duhet të instalohen pajisjet matëse të energjisë termike që i plotësojnë kërkesat e këtij Kodi.
- 9.4.3 Në rastet kur **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i aftë të demonstrojë bindshëm se një sistem / pajisje matëse që nuk i plotëson kërkesat e këtij Kodi por i plotëson:
- i) kërkesat e gjitha rregulloreve tjera relevante dhe specifikimet dhe standardet përkatëse teknike, dhe kërkesat e sigurisë;
 - ii) kërkesat e tarifave të përdoruesve të sistemit; dhe

iii) është brenda periudhës së verifikimit;

atëherë sistemi / pajisja matëse mund të mbetet në shërbim deri në përfundim të periudhës verifikuese.

10. Siguria e Pajisjeve të Matjes

10.1 Vendndodhja e Pajisjeve Matëse

10.1.2 Mënyra e vetme e mundshme për t'i siguruar **pajisjet matëse** nga dëmtimi fizik është nëse ato instalohen në një vend të përshtatshëm.

10.1.3 Vendi i zgjedhur për instalimin e **pajisjeve matëse të energjisë termike** duhet në të gjitha rastet të jetë:

- i mbrojtur nga hyrja e personave të paautorizuar dhe kafshëve që mund të shkaktojnë dëmtime,
- larg nga materialet e djegshme në një distancë prej 1.5 metrash në të gjitha drejtimet,
- i mundshëm lehtësisht për hyrjen e përfaqësuesve të **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** nga pika në të cilën ata hyjnë për në pronë.

10.2 Vulosja e Pajisjeve Matëse

10.2.1 Përveç vulës së kalibrimit e cila vendoset nga organizata përgjegjëse për kalibrimin e matësit, vulat e instalimit duhet të vendosen për të siguruar zbulimin e ndërhyrjeve të mundshme në paprekshmërinë e aparaturave matëse.

10.2.2 Të gjitha **pajisjet matëse të energjisë termike** do të vulosen pas **montimit** fillestar dhe do të vulosen prapë pas çdo ndërhyrjeje të mëvonshme e cila kërkon heqjen e vulave. Për të siguruar që vulat e vjetra nuk mund të rivendosen në pajisje në mënyrë të atillë që të fshehin ndërhyrjet e paautorizuara, të gjitha vulat e vjetra do të hiqen nga vendi dhe do të asgjësohen nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes**

10.3 Forma e Vulës

10.3.1 Një vulë instalimi duhet të përbëhet nga dy pjesë – një pjesë e shkurtër teli dhe një unazë metalike vulosëse – të cilat kur lidhen së bashku dhe shtrëngohen me një pajisje vulosëse do të parandalojnë heqjen e vulës pa një shenjë të qartë të kësaj heqjeje. Specifikimi i mëposhtëm për vulën ka për qëllim të sigurojë që vula nuk mund të thyhet apo hiqet në mënyrë të arsyetueshme aksidentale.

10.3.2 Teli duhet të jetë 150 mm i gjatë, të ketë një diametër minimal prej 0.9 mm, të ketë një ngarkesë të thyerjes prej të paktën 880 N dhe të jetë punuar nga 7 fije teli prej çeliku të veshur me zink.

10.3.3 Unaza e metalit duhet të jetë një unazë bakri e kalitur dhe e shtypur me gjatësi ndërmjet 5.0 dhe 6.0 mm me një diametër të brendshëm ndërmjet 1.95 dhe 2.25 mm, me diametër të jashtëm ndërmjet 4.0 dhe 4.6 mm dhe mund të ndërtohet në një mënyrë të tillë që në asnjë pikë gjerësia e unazës nuk është më i vogël se 0.8 mm.

10.3.4 Pajisja vulosëse përfshinë një pajisje shtypëse dhe stampat në mënyrë të atillë që pajisja do të shtypë unazën në fillin e telit dhe vulosja e formuar do të durojë një shtypje prej 200 N pa u thyer. Stampat me shtypje do të dizajnohen për të shënjuar unazën e shtypur në të dyja anët:

- Në një rën anë me një shenjë identifikuese ose me deri në 3 shkronja ose numra të cilat identifikojnë **Operatori i rrjetit të shpërndarjes**, dhe
- Në anën tjetër me 3 shkronja ose numra do të identifikojnë secilin operator i cili ka vendosur vulën.

10.4 Kontrolli i Pajisjeve Vulosëse

10.4.1 Pajisja vulosëse duhet të sigurohet nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** për secilin operatorë të autorizuar për të hequr dhe zëvendësuar vulat e instaluara. Përveçse kur kryhen punë urgjente, asnjë operator të cili është dhënë një pajisje vulosëse, nuk i lejohet të heqë një vulë të instaluar.

10.4.2 Në qoftë se janë kryer punë urgjente që kanë pasur nevojë për heqjen e një vule **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duhet të sigurojë që puna e cila është kryer duhet të inspektohet më pas nga një operator i cili është i autorizuar të heqë dhe të vendosë vulat e instaluara dhe që instalimi të vuloset përsëri nga ai operator i autorizuar i **Operatorit të rrjetit të shpërndarjes**. **Operatorit të rrjetit të shpërndarjes** duhet të sigurojë për operatorin i cili i ri-vulos instalimet, qasje në instalime, të dhëna të punimeve të kryera dhe të atyre të cilët kanë ndërmarrë punët në mënyrë të atillë që ai punëtor të mund të sigurojë vetveten për integritetin e instalimit që është duke u vulosur përsëri.

10.4.3 Vulat e shtypura nuk duhet të barten ndërmjet operatorëve dhe asnjë nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** nuk duhet të mbajë kopje të dyfishta të vulave. Kur operatori mbaron punën e vulosjes së pajisjeve në emër të **Operatorit të rrjetit të shpërndarjes**, **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duhet të shkatërrojë menjëherë vulat e shtypura të lëshuara për një operator.

10.4.4 Vulat e shtypura të cilat nuk mund të mbajnë shenja të lexueshme nuk duhet të përdoren dhe duhet të shkatërrohen menjëherë nga **Operatori i rrjetit të shpërndarjes**. **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** mund të caktojë që të prodhohen dhe t'i dorëzohen operatorit një grup zëvendësues vlash me të njëjtin identifikim ose ndryshe t'i jepet operatorit një pajisje vulosëse zëvendësuese me një identifikues të ndryshëm.

10.4.5 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duhet të mbajë të dhëna se kur i dorëzohet një pajisje vulosëse një operator ose kur dërgohet pajisja për riparim. Për vulat në përdorim, kjo e dhënë duhet të përmbajë:

- shenjën identifikuese të secilit grup vlash në përdorim,
- emrin e personit të cilit iu dorëzuan vulat ose kompanisë së cilës i janë dërguar për riparim,
- datën e lëshimit dhe kthimit.

10.4.6 Për vulat e shkatërruara tregohet data dhe arsyeja e shkatërrimit të tyre.

10.4.7 Për vulat që kanë humbur ose janë vjedhur, duhet të mbahet një shënim që tregon datën dhe vendin e humbjes.

10.4.8 Të gjitha të dhënat e marra në përputhje me paragrafët 10.4.6 dhe 10.4.7 duhet të mbahen për një periudhë prej 10 vjetësh nga shkatërrimi ose humbja e vulave.

10.4.9 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** obligohet që të riprodhojë vulat nëse kjo kërkohet nga Rregullatori dhe për këtë duhet të bëjë një njoftim.

11 Testimi i Sistemeve / Pajisjeve Matëse

11.1 Përgjithësisht

11.1.1 Testimi i pajisjeve matëse të energjisë termike në tërësi dhe të komponentëve individualë të sistemeve ndërmerret në disa faza:

- para dhënies së miratimit të tipit,
- gjatë kalibrimit dhe verifikimit të komponentëve individual menjëherë para ose në mes të instalimit,
- ri-verifikimi në disa faza gjatë jetë-gjatësisë së pajisjeve përcaktuar nga tipi gjenerik i komponentit ose tipi specifik i komponentit, cilido që është më i shkurtër.

11.1.2 Në rastet e sistemeve matëse në pikat e kycjes ku transferimi i energjisë është i madh, duhet të ndërmerret verifikimi i kalibrimit në periudha (intervale) të rregullta kohore.

11.2 Aprovimi i Tipeve (Llojeve) të pajisjeve matëse të energjisë termike

11.2.1.1 Sipas Ligjit për Metrologji Nr. 02/L-34, do të jetë përgjegjësia e **Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (Ministria)** përkatësisht **Institutit të Metrologjisë Ligjore në kuadër të Ministrisë**, të aprovojë përdorimin e tipeve (modeleve) të caktuara të pajisjeve matëse të energjisë termike si komponentë e **sistemeve matëse** komerciale në Kosovë. Përpara se të lëshohet një certifikate miratimi, **Instituti i Metrologjisë Ligjore** në kuadër të **Ministrisë** do të ndërmarrë teste të atilla miratimi të tipit siç kërkohet nga ligji ose që mendon se janë të përshtatshëm në rrethanat e caktuara.

11.2.1.2 **Ministria** ka të drejtë të udhëzojë një laborator të përshtatshëm të akredituar për të ndërmarrë testet e aprovimit të tipit në emër të saj.

11.2.1.3 Aty ku pajisjet matëse janë pajisje të një modeli për të cilin është dhënë miratim nga Bashkimi Evropian dhe nuk është revokuar nga ndonjëri nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose ndonjë shtet tjetër në Zonën Ekonomike Evropiane, atëherë **Instituti i Metrologjisë Ligjore** në kuadër të **Ministrisë** do t'i jepet e drejta të lëshojë një certifikatë miratimi pa ndërmarrë ndonjë testim të mëtejshëm.

11.2.1.4 Të dhënat të cilat do të specifikohen në këtë Certifikatë janë:

- Emërtimi i pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje
- Shenja e tipit themelor
- Certifikata e kualitetit

- Shenja zyrtare e tipit të Pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje
 - Afati i vlefshmërisë së Certifikatës
- 11.2.1.5 Certifikata duhet të përmbajë edhe deklaratën se me shqyrtimin e tipit të përmendur të pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje është vërtetuar se Pajisja në fjalë matëse e energjisë termike për ngrohje i plotëson kushtet metrologjike të parapara në Rregulloren për kushtet metrologjike për Pajisjet matëse të energjisë termike për ngrohje.
- 11.2.1.6 Në Shtesën e Certifikatës për aprovimin e tipit të pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje duhet të jepen edhe shënimet në vazhdim:
- Karakteristikat metrologjike të Pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje
 - Shikimi dhe vulosja e Pajisjes matëse të energjisë termike për ngrohje
 - Vërejtje eventuale
- 11.2.1.7 Në rast se hiqet miratimi i tipit të ndonjë matësi nga **Instituti i Metrologjisë Ligjore** në kuadër të **Ministrisë** atëherë **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** do të zëvendësojë pajisjet matëse të energjisë termike brenda 6 muajsh nga marrja e vendimit për revokim.

11.3 Kalibrimi dhe Verifikimi

- 11.3.1.1 Të gjitha **pajisjet matëse** do të kalibrohen dhe verifikohen në përputhje me ligjet e Kosovës përpara fillimit të operimit komercial.
- 11.3.1.2 Aty ku **pajisjet matëse të energjisë termike** mbajnë shenjën verifikuese fillestare të Bashkimit Evropian dhe/ose janë të vulosura nga vulat e kalibrimit të një laborator testimi të autorizuar për kalibrim dhe verifikim të pajisjeve matëse në ndonjë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose ndonjë shteti tjetër në Zonën Ekonomike Evropiane dhe kane certifikate kualiteti, atëherë pajisjet do të pranohen si të kalibruara dhe të verifikuara në Kosovë.

11.4 Kalibrimi periodik dhe riparimi gjeneral

- 11.4.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që të bëjë testimin, ri-kalibrimin dhe/ose riparimin e sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike në periudha të caktuara siç përcaktohet në certifikatë ose nga **Ministria**; po ashtu edhe obligimi për verifikimin e pajisjeve matëse të energjisë termike pas riparimit.
- 11.4.2 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** është i obliguar që të bëjë verifikimin e sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike pas riparimit të tyre.
- 11.4.3 Është e domosdoshme që **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** të regjistrojë në regjistrin e sistemeve / pajisjeve matëse datat e të gjitha testimeve.
- 11.4.4 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** ka mundësi të kryej testime tjera të veçanta të sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike jashtë testimeve të përcaktuara me dispozitat e këtij Kodi.

12. Pagesa për sistemet matëse

- 12.1 **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** ka të drejtë që të rikthej (mbuloj) shpenzimet lidhur me instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e sistemeve / pajisjeve matëse të energjisë termike përmes tarifës së qasjes në rrjet, ndërsa në rastin e kyçjeve të reja përmes tarifës (pagesës) së kyçjes sipas marrëveshjes për kyçje.
- 12.2 Kur një përdorues i sistemit kërkon ndryshimin (ndërrimin) e sistemit / pajisjes matëse të energjisë termike, atëherë **Operatori i rrjetit të shpërndarjes** duhet të bëjë ndërrimin e pajisjes matëse me një të ri gjithmonë në harmoni me dispozitat e këtij Kodi, ndërsa shpenzimet lidhur me instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e sasisë së shpenzuar të energjisë termike nga pajisja matëse e energjisë do t'ia faturojë përdoruesit të sistemit në faturën e radhës për energjinë e shpenzuar për ngrohje.

[Fundi i Dokumentit]